

## 2.9.7 INFORMATA rreth GJUHËS GJERMANE si gjuhë të dytë ( DaZ )

Rregullore për kopështet e fëmijëve dhe shkollat fillore:

### § 44 Rregullat themelore

Nxënëset dhe nxënësit gjuhë folës të huaj, të sapo ardhur në Zvicër, paraprakisht pranohen në vitin përkatës duke u bazuar në vitin e lindjes. Nxënëset dhe nxënësit në mungesë të njohurive të mjaftueshme të gjuhës gjermane, kanë të drejtë të marrin pjesë në një ofertë për avansim për gjuhë folësit e huaj, pa marrë parasysh kohën e ardhjes së tyre në Zvicër. Drejtoria e shkollës vendos për pranimin në kurs të gjermanishtes si gjuhë të dytë, në ndonjë kurs intensiv të gjermanishtes apo në klasë integruese.

### § 45 Kurse të gjuhës gjermane si gjuhë të dytë

Nxënëset dhe nxënësit gjuhë folës të huaj me njohuri jo të mjaftueshme të gjuhës gjermane, mund të vizitojnë kurse të gjuhës gjermane si gjuhë të dytë nëpër kopështe të fëmijëve dhe në shkolla fillore, e cila mund të mbahet me 2 deri me 6 nxënëse dhe nxënës. Në raste të veçanta drejtoria e shkollës mund të lejojë mësim edhe për një nxënës.

Kurset nëpër kopështe të fëmijëve mund të vizitohen përgjatë dy viteve dhe vazhdohet deri në fund përgjatë tre viteve të shkollës fillore. Secili kurs në dispozicion ka 2 leksione për kopështet e fëmijëve përgjatë javës shkollore, dhe 1 deri në 2 leksione për shkolla fillore.

### § 46 Kurs intensiv i gjuhës gjermane

Nxënëset dhe nxënësit, gjuhë folës të huaj, të cilët nuk e flasin gjuhën gjermane, mund ta vizitojnë një kurs intensiv të gjuhës gjermane si në kopështet e fëmijëve ashtu edhe në shkollat fillore, ku mund të marrin pjesë 2 deri në 4 nxënëse dhe nxënës. Në raste të veçanta drejtoria e shkollës mund të lejojë mësim edhe për një nxënës. Kursi intensiv përmban në vete për një javë shkollore: a. në kopësht të fëmijëve 4 leksione; b. në klasën e parë dhe të dytë të shkollës fillore 4 deri 6 leksione; c. në klasën e tretë deri të pestën të shkollës fillore 4 deri 8 leksione.

Kursi zgjatë më së shumti një vit. Në fund të kursit intensiv nxënëset dhe nxënësit mund ta vizitojnë kursin e gjuhës gjermane si gjuhë të dytë përgjatë 3 viteve shkollore.

- Mësimi mbahet në kopësht të fëmijëve (Kindergarten) përgjatë mësimin të rregullt të kopështit të fëmijëve.
- Për kurset e gjuhës gjermane si gjuhë të dytë, përgjegjës është një mësimdhënës i specializuar. Prindërit do të njoftohen që në fillim të vitit shkollor me një letër informative, se kur mund ta vizitojë fëmija juaj kursin e gjuhës.
- Në shkollë, gjatë mësimin përdoret gjuha standarde
- Me ndihmën e fotografive, gjësendeve, lëvizjeve, lojrave dhe këngëve, fëmijët mësojnë gjuhën në formë loje.